



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 67/1 prot.

Tiranë më 21.1.2019

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për opinion ligjor

AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 184 Prot., datë 15.01.2019, me anë të cilës kërkohet opinion lidhur me ligjshmërinë e ruajtjes së të dhënave personale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Zyra e Komisionerit vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me procesin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.

Në referencë të pikës 22 të nenit 3 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, "*Transferim ndërkombëtar*", është dhënia e të dhënave personale marrësve në shtetet e huaja. Në rastin konkret, Shoqëria "Regjistri Shqiptar i Titujve – ALERG" sh.a, (në cilësinë e transferuesit të të dhënave) do të përpunojë të dhënat personale nëpërmjet sistemit "Quick Clear", serverat e të cilit janë hostuar në Slloveni dhe janë në pronësi të kompanisë Sllovene "Market Evolution Software Products Limited" (në cilësinë e marrësit të të dhënave personale).

Paraprakisht, vlerësojmë se proceset e transferimit ndërkombëtar të të dhënave në parim gjejnë mbështetje ligjore (në vijim do të saktësojmë bazën ligjore) dhe në këtë drejtim ka një praktikë të konsoliduar në nivel ndërkombëtar por edhe atë kombëtar.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale parashikohet në nenet 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Në parim transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Sllovenia, në referim të Vendimit nr. 8, datë 31.10.2016 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", konsiderohet si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale dhe në këtë kuadër transferimi i të dhënave mund të bëhet pa patur nevojë për autorizim paraprak nga Zyra e Komisionerit.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kategorive të të dhënave personale që synohen të përpunohen dhe transferohen, Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi Shoqëria

